



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 02 /2016 PËR AKTIVITETET JASHTËSHKOLLORE

ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MEST) NO. 02 /2016 ON EXTRACURRICULAR ACTIVITIES

ADMINISTRATIVNA UREDBA (MONT) BR. 02 /2016 VANŠKOLSKE AKTIVNOSTI

<p>Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 23 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, (Gazeta zyrtare nr. 17 / 16 shtator 2011), nenit 8 nënparagrafi 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë nr. 09/2011 (Gazeta zyrtare nr. 15, 12.09.2011), nxjerr:</p>	<p>Ministry of Education, Science and Technology, pursuant to article 23 of the Law for Pre-university education in the Republic of Kosovo, (Official gazette no. 17, 16 September 2011), article 8 subparagraph 1.4 of the regulation no. 02/2011 for fields of administrative responsibility of the Prime Minister's Office and Ministries and article 38 paragraph 6 of the Government's Rules of Procedure no.09/2011, Ministry of Education, Science and Technology (MEST), issues:</p>	<p>Ministar obrazovanja, nauke i tehnologije, Na osnovu član 23 Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju u Republiku Kosova, (Službeni glasnik br.17/16 septembar 2011). član 8 pod stav 1.4. Pravilnka br. 02/2011 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva kao i član 38 stav 6 Poslovnka o radu Vlade br. 09/2011, (Službeni glasnik br. 15, 12.09.2011) izdaje:</p>
<p>UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASHT) NR. <u>02</u> /2016 PËR AKTIVITETET JASHTËSHKOLLORE</p>	<p>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MEST) NO. <u>02</u> /2016 ON EXTRACURRICULAR ACTIVITIES</p>	<p>ADMINISTRATIVNU UREDBU BR. <u>02</u> /2016 VANŠKOLSKE AKTIVNOSTI</p>
<p>Neni 1 Qëllimi</p>	<p>Article 1 The purpose</p>	<p>Član 1 Cilj</p>
<p>1. Qëllimi i këtij Udhëzimi administrativ është rregullimi normativ i:</p> <p>1.1. Vizitave në muze, parqe, natyrë, vende historike, institucione, etj;</p> <p>1.2. Festimit të datave të veçanta, ngjarjeve, traditave, arritjeve në shkollë;</p> <p>1.3. Pjesëmarrjes së nxënësve në vendimmarrje në shkollë dhe formave të</p>	<p>1. The purpose of this administrative instruction is normative regulation of:</p> <p>1.1. Visits in museums, parks, nature, historical places, institutions etc.</p> <p>1.2. Celebration of special dates, events, traditions, achievement in school,</p> <p>1.3. Participation of students in school decision making and other forms of</p>	<p>1. Cilj ove administrativne uredbe je normativno regulisanje:</p> <p>1.1. Poseta muzejima, parkovima, prirodi, istorijskim mestima, institucijama itd.</p> <p>1.2. Proslava posebne datume, događaje, tradicija, dostignuća u školi;</p> <p>1.3. Učešće učenika u školskom</p>

<p>tjera të demokracisë në shkollë;</p> <p>1.4. Aktiviteteve të lira: arte të bukura, fotografi, ese, etj. lojra, kor, revista të shkollës, radio të shkollës, televizion të shkollës si dhe klubet e shkollës;</p> <p>1.5. Shërbime për bashkësinë (ndihmë për ata që kanë nevojë, fuqizimi i lidhjeve midis gjeneratave, zhvillimi i fushatave për zhvillimin e bashkësisë);</p> <p>1.6. Promovimi i shëndetit dhe mbrojtja e mjedisit;</p> <p>1.7. Shëtitjet, pikniqet, mbrëmjet e maturës dhe ekskursionet.</p>	<p>democracy in school.</p> <p>1.4. Free activities: fine arts, photos, essays, etc. games, choir, school magazine, school radio, school television and school clubs.</p> <p>1.5. Community services (help for those that in need, strengthen of links between generations, development of campaigns for community development)</p> <p>1.6. Promotion of health and environment protection;</p> <p>1.7. Walks, picnics, graduation night and excursions</p>	<p>odlučivanju i drugim oblicima demokratije u školi;</p> <p>1.4. Slobodne aktivnosti: likovne umetnosti, fotografije, eseji, igre, hor, školske časopise, školski radio, školska televizija kao i školski klubovi;</p> <p>1.5. Usluge zajednici (pomoć za one kojim je potrebno, jačanje veza među generacije, održavanje kampanja za razvoj zajednice);</p> <p>1.6. Promovisanje zdravlja i zaštita sredine;</p> <p>1.7. Izleti, piknik, matursko veće i ekskurzije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 2 Vizitat</p> <p>1. Vizita e nxënësve në muze, parqe, natyrë, vende historike, institucione, etj., si dhe vizita të tjerëve në shkollë (diskutime me të ftuar, udhëheqës të bashkësisë, prindër, përfaqësues të bizneseve lokale, politikanë, njerëz të mediave, mjekë, profesorë universitarë, etj).</p> <p>2. Vizitat organizohen për nivelin 1,2 dhe 3 të nxënësve brenda territorit të komunës përkatëse.</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Visits</p> <p>1. Students visit in museum, parks, nature, historical places, institutions, etc., and other visits in school (discussions with guests, leaders of community, parents, representatives of local businesses, politicians, media people, doctors, university professors etc).</p> <p>2. Visits are organized for 1, 2 and 3 of students' level within the relevant municipal territory.</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Posete</p> <p>1. Poseta muzeje, parkove, prirode, istorijska mesta, institucije itd, kao i posete drugima školama (debate sa pozvanim gostima, rukovodioca zajednice, roditelje, predstavnike biznisa, lokalne, političare, osobe iz medija, lekara, profesora univerziteta, itd).</p> <p>2. Posete se organiziraju za 1, 2 i 3 nivo učenika unutar teritorija dotične opštine,</p>

<p>3. Mësuesi, respektivisht mësimsdhënësi i lëndës, e cakton institucionin shoqëror, ekonomik, historik, kulturor, etj, të cilin do ta vizitojë dhe e përshkruan qëllimin e vizitës.</p>	<p>3.The teacher, respectively the subject teacher assigns social, economic, historical, cultural institution etc., which he will visit and describe the visits purpose.</p>	<p>3. Uçitelj, odnosno predmetni nastavnik određuje društvenu, privrednu, istorijsku, kulturnu i drugu instituciju koju će posetiti i opisuje svrhu posete.</p>
<p>3.1. Mësuesi ose mësimsdhënësi i lëndës mund ta zhvillojë një temë të caktuar sipas planprogramit në institucionin përkatës;</p>	<p>3.1. The teacher or subject teacher could develop a certain topic according to curriculum in the relevant institution</p>	<p>3.1. Uçitelj ili predmetni nastavnik može odvijati određenu temu prema plan i program dotične institucije;</p>
<p>3.2. Temën mund ta shtjellojë mësuesi ose i autorizuari i institucionit;</p>	<p>3.2. The topic could be elaborated by teacher or the authorized by the institution</p>	<p>3.2. Temu može razvijati učitelj ili lice ovlašteno od strane institucije;</p>
<p>3.3. Mësimsdhënësit për trajtimin e temave të ndryshme, mund të ftojë në klasë dhe shkollë, prindër të profesioneve të ndryshme, përfaqësues të komunitetit, politikanë, njerëz të shquar që kanë kontribuar për arsimin dhe shoqërinë në tërësi, me të cilët mund të diskutohet, të shqyrtohet ndonjë temë me interes për nxënësit;</p>	<p>3.3. Teachers for treatment of different topics could invite in class and school, parents of different occupations, community representatives, politicians, remarkable people who have contributed to education and society in general, with whom you can discuss, to review any topic of interest to students.</p>	<p>3.3. Nastavnik za obradu različite teme, ima pravo da pozove u razred ili školu, roditelje različitih profesija, predstavnike zajednice, političare, ugledne ličnosti koji su doprineli obrazovanju i društvu u celini, sa kojim može da se razgovara, da se obradi neka interesantna tema od posebnog značaja za učenike;</p>
<p>3.4. Mësimsdhënësit paraprakisht konsultohen dhe marrin miratim me shkrim prej drejtorit të shkollës dhe miratimin me shkrim nga prindërit e nxënësve për këto vizita; vizitat duhet të jenë pjesë e planit vjetor të mësimsdhënësit;</p>	<p>3.4. Teachers are consulted in advance and take approval from school principal and approval of students' parents for these visits; visits must be part of the annual plan of teachers;</p>	<p>3.4. Nastavnici prethodno se konsultuju i dobijaju pismeno odobrenje direktora škole i pismeno odobrenje roditelje učenika za ovakve posete; Posete bi trebalo da bude deo godišnjeg plana nastavnika;</p>

<p>3.5. Në vizitat që ndodhin jashtë qytetit /vendbanimit përkatës ku duhet edhe transporti i organizuar i nxënësve, duhet të konsultohet Këshilli drejtues i shkollës dhe duhet të ftohet edhe përfaqësuesi i prindërve të klasës;</p>	<p>3.5. In visits that occur outside the city / the respective residence and where organized transport of students is also needed, steering school council must be consulted and parents' members of the class must be invited.</p>	<p>3.5. Za posete koje će se obaviti van grada/dotičnog mesta boravka za koje se treba organizovati organizovani transport učenika, treba se konsultovati sa školskim Upravnim odborom i treba da bude pozvan i predstavnik roditelja za razred;</p>
<p>3.6. Vizitat e bëra si jashtë shkollës, po ashtu edhe ato brenda shkollës shënohen në ditar në rubrikën e orës mësimore, si dhe vendoset tema e trajtuar.</p>	<p>3.6. Visits made outside school, as those within the school are marked in a diary in rubric of the teaching hour and is placed the treated topic.</p>	<p>3.6. Posete obavljene van škole i unutar škole evidentiraju se u dnevnik u rubrici nastavnog časa, kao i navode se obrađene teme.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3</p>	<p style="text-align: center;">Article 3</p>	<p style="text-align: center;">Član 3</p>
<p style="text-align: center;">Festimi i datave të veçanta, ngjarjeve, traditave, arritjeve në shkollë</p>	<p style="text-align: center;">Celebration of special dates, events, traditions, achievements in school</p>	<p style="text-align: center;">Proslava posebne datume, događaje, tradicije, dostignuća u školi</p>
<p>1. Programin për festimin e ditës së shkollës, për festat shtetërore dhe festat tjera e bën Këshilli organizues, të cilin e cakton drejtori i shkollës në bashkëpunim me aktivet e mësimdhënësve.</p>	<p>1. The programme for celebration of school day, state holidays and other holidays does the organizing committee, which assigns the school principal in cooperation with professional groups of teachers.</p>	<p>1. Program za proslavu dan škole, državne i druge praznike priprema Organizacioni odbor, kojeg određuje direktor škole u saradnji sa školskim aktivima.</p>
<p>2. Programi përmban pjesë të zgjedhura artistike sipas kriterëve profesionale, të cilin e përgatisin mësimdhënësit dhe nxënësit.</p>	<p>2. The programme contains selected artistic parts according to professional criteria's, which is prepared by teachers and students.</p>	<p>2. Program sadrži izabrani umetnički deo prema profesionalnim kriterijumima, kojeg pripremaju nastavnici i učenici.</p>
<p>3. Me rastin e përfundimit të vitit të fundit të nivelit 1 ose 2 (të klasës së 5-të respektivisht të klasës së 9-të), shkolla</p>	<p>3. On the occasion of conclusion of the last year of level 1 and 2 (of grade 5th respectively of grade 9th), the school could</p>	<p>3. Povodom završetka zadnje godine 1 ili 2 nivo (5 odnosno 9-ti razred), škola ima pravo da organizuje ceremoniju dodele</p>

<p>mund të organizojë një ceremoni për dorëzimin e certifikatave, respektivisht diplomave për nxënësit e këtyre klasëve.</p> <p>4. Ceremonia organizohet në lokalet e shkollës.</p> <p>5. Nxënësit të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të, me miratimin e Këshillit drejtues të shkollës, mund të organizojnë ceremoninë edhe jashtë shkolle me pëlqimin paraprak të prindërve dhe atë gjatë ditës, jo në mbrëmje.</p> <p>6. Në organizimin e këtyre festave, për shkollat ku ka edhe mësimdhënës dhe nxënës të komuniteteve tjera pakicë, ftohen të gjithë në pjesëmarrje për të respektuar diversitetin kulturor të shkollës.</p>	<p>organize a ceremony for submission of certificates, namely diplomas for students of these classes.</p> <p>4. The ceremony is organized in school premises.</p> <p>5. Students who have completed 9th grade, with approval of Steering school Council, could organize the ceremony even outside the school with prior consent of parents and that during the day, not in the evening.</p> <p>6. In organizing these holidays, for schools where there are teachers and students of other minority communities, are invited all to participate in honouring the cultural diversity of school.</p>	<p>certifikata, odnosno diploma za učenike ovih razreda.</p> <p>4. Ceremonija se organizuje u školskim prostorijama.</p> <p>5. Učenici koji su završili 9-ti razred, uz odobrenje školskog Upravnog saveta, mogu organizovati ceremoniju i van škole uz prethodnu saglasnost roditelja u toku dan, ne noću.</p> <p>6. Prilikom organizovanje ove proslave, za škole u kojim ima i učenici i nastavnici iz druge manjinske zajednice, pozivaju se svi učesnici kako bi se ispoštovao školski kulturni diverzitet.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 4 Mbrëmja e maturës</p> <p>1. Mbrëmja e maturës organizohet bashkërisht, për të gjithë maturantët e shkollës, pavarësisht gjuhën në të cilën e kanë mbaruar shkollimin.</p> <p>2. Mbrëmja e maturës organizohet në lokalet e shkollës ose në lokalet tjera brenda territorit të komunës përkatëse.</p> <p>3. Pjesëmarrja dhe mbikëqyrja nga drejtori</p>	<p style="text-align: center;">Article 4 Graduation evening</p> <p>1. Graduation evening is organized jointly, for all school graduates, despite the language in which they have finished the school.</p> <p>2. Graduation evening is organized in school premises or in other premises within the territory of respective municipality.</p> <p>3. Participation of principal and class</p>	<p style="text-align: center;">Član 4 Matursko veće</p> <p>1. Matursko veće organizuje se zajednički, za sve maturante škole, bez obzira na jezik na kojem su završili školovanje</p> <p>2. Matursko veće se organizuje u školskoj prostoriji ili u drugim lokalima na teritoriji dotične opštine.</p> <p>3. Učešće i nadzor direktora škole i</p>

<p>dhe kujdestarët e klasave është e obliguar.</p> <p>4. Në mungesë të drejtorit dhe zëvendësit, Këshilli drejtues i shkollës e cakton përgjegjësin për këtë ceremoni nga personeli mësimdhënës.</p> <p>5. Drejtori ose personi tjetër i autorizuar është i obliguar së paku 7 ditë më herët t'i njoftojë maturantët dhe prindërit e tyre për obligimet dhe përgjegjësitë e maturantëve për mbrëmje.</p> <p>6. Pas mbarimit të ceremonisë përgjegjësia për maturantët bie mbi prindërit e tyre.</p> <p>7. Pas mbarimit të programit, nxënësit nuk mund të organizojnë ndëja apo diç të ngjashme në emër të shkollës.</p> <p>8. Prindërit njoftohen se nxënësve pas përfundimit të mbrëmjes së maturës nuk u lejohet asnjë organizim tjetër.</p>	<p>wardens is obliged.</p> <p>4. In director's and deputy director's absence, Steering school council assigns the responsible person for this ceremony from the teaching staff.</p> <p>5. The director is obliged that at least 7 days earlier to notify graduates and their parents for obligations and responsibilities of graduates for the evening.</p> <p>6. After the end of the ceremony, responsibility of graduates falls over their parents.</p> <p>7. After the end of programme, students cannot organize gatherings or something similar on school's behalf.</p> <p>8. Parents are notified that students are not allowed any other gathering after the end of graduation evening</p>	<p>razrednog starešine je obavezno.</p> <p>4. U odsustvu direktora i zamenika, školski Upravni odbor određuje odgovornog za ovu ceremoniju iz redova nastavnog osoblja</p> <p>5. Direktor ili drugo ovlašćeno lice je dužno najmanje 7 dana unapred da obavesti maturante i njihove roditelje za obaveze i odgovornost maturanata za to večer .</p> <p>6. Nakon završetka ceremonije odgovornost za maturante preuzimaju njihovi roditelji.</p> <p>7. Po završetku programa, učenici ne mogu da organizuju skupove ili nešto slično u ime škole.</p> <p>8. Obaveštavaju se roditelji da učenicima nakon završetka maturalne večeri nije dozvoljeno da nikakvo drugo organizovanje.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 5</p> <p style="text-align: center;">Pjesëmarrje në vendimmarrjen e shkollës dhe formave të tjera të demokracisë në shkollë</p> <p>1. Shkolla obligohet të formojë Këshillat e nxënësve për nivelin 2 dhe 3 të arsimit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 5</p> <p style="text-align: center;">Participation in school decision-making and other forms of democracy in school</p> <p>1. Schools are obliged to form students Councils for 2nd and 3rd level of education,</p>	<p style="text-align: center;">Član 5</p> <p style="text-align: center;">Učesće u školskom odlučivanju i drugim oblicima demokratije u školi</p> <p>1. Škola je obavezna da formira Savet učenika za 2 i 3 nivo obrazovanja.</p>

<p>2. Përfaqësuesi i nxënësve të nivelit 2 dhe 3 duhet të jetë anëtar i Këshillit drejtues të shkollës.</p> <p>3. Nxënësit e çdo klase e zgjedhin përfaqësuesin e tyre për t'i përfaqësuar në Këshillin e nxënësve të shkollës.</p> <p>4. Këshilli i nxënësve duhet të ketë kryesinë prej 5 anëtarëve, prej të cilëve një është kryetar i këtij këshilli.</p> <p>5. Anëtarët dhe kryetari zgjedhen me votim të fshehtë prej të gjithë përfaqësuesve të këshillit, pasi të jetë propozuar lista me kandidatë për anëtarë të kryesisë, si dhe kandidatë për kryetar të Këshillit të nxënësve.</p> <p>6. Kandidatët që marrin më shumë vota bëhen anëtarë të kryesisë, si dhe zgjedhet edhe kryetari.</p> <p>7. Në këto zgjedhje nuk duhet të ketë ndikim drejtori i shkollës, e as Këshilli drejtues i shkollës.</p>	<p>2. Students representative of 2nd and 3rd level must be member of Steering school council,</p> <p>3. Students of each class select their representative to represent in School student council,</p> <p>4. Student council should have the headship of 5 members, from which one is chairman of this council,</p> <p>5. Members and the chairman are selected with secret ballot from all representatives of the council, after the proposed list with candidates for members of the headship, as well as candidate for chairman of students council,</p> <p>6. Candidates that take more votes, become members of headship, and the chairman is also elected.</p> <p>7. In this election the school principal, nor the steering school council should not affect.</p>	<p>2. Predstavnik učenika 2 i 3 nivoa treba da bude član školskog Upravnog odbora.</p> <p>3. Učenici iz svaki razred biraju svog predstavnika koji će zastupati učenike u školski Savet učenika</p> <p>4. Savet učenika mora da ima predsedništvo od 5 članova, od kojih je jedna predsednik ovog saveta.</p> <p>5. Članove i predsednika biraju tajnim glasanjem iz svih predstavnike saveta, nakon što bude predložena lista kandidata za članove predsedništva, kao i kandidate za predsednika Savet učenika.</p> <p>6. Kandidati sa najviše osvojenih glasova postaju članovi predsedništva, od koje jedan od njih će biti izabran za predsednika.</p> <p>7. Na ovim izborima ne treba da utiče direktor škole a ni školski Upravni odbor.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 6 Aktivitetet e lira</p> <p>1. Aktivitetet e lira: arte të bukura,</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Leisure activities</p> <p>1. Leisure activities: fine arts, photos,</p>	<p style="text-align: center;">Član 6 Slobodne aktivnosti</p> <p>1. Slobodne aktivnosti: likovan umetnost,</p>

<p>fotografi, ese, aktivitete sportive, kor, revista të shkollës, radio të shkollës, televizion të shkollës, etj.</p> <p>2. Drejtoria e shkollës dhe aktivet e mësimdhënësve duhet të organizojnë aktivitete të ndryshme, që janë kërkesë edhe e kurrikulës së arsimit, me ç’rast aktivizohen të gjithë nxënësit pa dallim.</p> <p>3. Mësimdhënësit organizojnë aktivitete të lira në kuadër të klasës, por edhe në kuadër të shkollës në përgjithësi sipas planifikimit të punës vjetore të shkollës.</p> <p>4. Shkolla duhet të formojë klubet e nxënësve me qëllim edukativ-arsimor, ku nxënësit me ndihmën e mësimdhënësve mund të organizohen, në mënyrë që t’i zhvillojnë shkathtësitë e tyre në fushat ku tregojnë më shumë interesim, si klubet e shkencës, klubet e artit, klubet sportive, etj.</p>	<p>essays, sports activities, choir, school magazines, school radio, school television etc.),</p> <p>2. School directorate and teachers professional groups should organize different activities, which are also requirement of the Education Curriculum, on which occasion are activated all students without distinction.</p> <p>3. Teachers organize free activities within the class, but also within the school in general according to the annual work planning of the school.</p> <p>4. The school should form students clubs with instructive-educational purpose, where students with teachers help could be organized, in order to develop their skills in areas where they show more interest, like science clubs, art clubs, sports clubs etc.</p>	<p>fotografije, eseji, sportske aktivnost, hor, školski časopisi, školski radio, školska televizija, itd).</p> <p>2. Školska direkcija sa nastavnim aktivima treba da organizuju različite aktivnosti, a što je i zahtev nastavnog kurikuluma, tim povodom aktiviraju se svi učenici bez diskriminacije.</p> <p>3. Nastavnici organizuju slobodne aktivnosti u okviru razre, ali i u okviru škole u celini prema godišnjem planu rada škole.</p> <p>4. Škole treba da osnuju klubove učenika u edukativno obrazovnom svojstvu, u kojim će učenici uz pomoć nastavnika moći da se organizuju, kako bi razvijali svoje veštine u oblastima u kojim pokazuju veću zainteresovanost, kao naučni klubovi, umetničke klubovi, sportski klubovi, itd.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 7</p> <p>Shërbime për bashkësinë (ndihmë për ata që kanë nevojë, fuqizimi i lidhjeve midis gjeneratave, zhvillimi i fushatave për zhvillimin e bashkësisë)</p> <p>1. Shkolla inkurajon dhe përkrah nismat e lira nga mësimdhënësit që promovojnë</p>	<p style="text-align: center;">Article 7</p> <p>Services to the community (help for those in need, strengthening bonds between generations, development of fields for development of community)</p> <p>1. The school encourages and supports free initiatives from teachers that promote</p>	<p style="text-align: center;">Član 7</p> <p>Usluge zajednici (pomoć onima kojim je potrebna, jačanje veza između generacija, održavanje kampanje za razvoj zajednice</p> <p>1. Škola podstiče i podržava slobodne inicijative nastavnika koji promovišu</p>

<p>pjesëmarrjen demokratike të mësimdhënësve dhe të nxënësve në çdo aktivitet që e organizojnë dhe organizohet në shkollë dhe jashtë shkolle.</p>	<p>democratic participation of teachers and of students in every activity that organize and is organized in school and outside the school.</p>	<p>demokratsko učešće nastavnika i učenika u svim aktivnostima koje organizuju i organizuju se u školi i van škole.</p>
<p>2. Prindërit janë kontribues të realizimit të aktiviteteve përmes pjesëmarrjes në forma të ndryshme kontribuese si, sigurim të materialeve didaktike, punë vullnetare për mirëmbajtjen e hapësirave të shkollës, vizitave në shkollë, për aktivitete të ndryshme që organizohen nga nxënësit, mjete financiare, etj.</p>	<p>2. Parents are contributors of activity implementation through participation in different contributing forms as, providing of didactic materials, voluntarily work for maintenance of school premises, visits in school for different activities that are organized from students, financial means etc.</p>	<p>2. Roditelji doprinose realizaciji aktivnosti kroz učešće u različitim aktivnostima doprinosa kao što je; obezbeđivanje didaktičkog materijal, dobrovoljni rad za održavanje školskih prostorija, posete školama, u vezi različite aktivnosti koje organizuju učenici, finansijska sredstva, itd.</p>
<p>3. Shkolla e inkurajon dhe i mundëson komunitet (siç është komuniteti lokal i biznesit, shërbimet civile, OJQ, etj.) të marrin pjesë në aktivitetet shkollore që ndihmojnë në krijimin e kushteve më të mira të punës dhe që janë në interesin më të mirë të nxënësve/fëmijëve.</p>	<p>3. The school encourages and enables community (such as the local business community, civil services, NGOs, etc) to participate in school activities helping in creation of better working conditions and which are in the best interest of students/children.</p>	<p>3. Škola podstiče i omogućava zajednici (kao što je lokalna zajednica biznisa, civilne usluge, NVO, itd) da učestvuju u školskim aktivnostima kako bi pomogli u stvaranju boljih uslova za rad i koji su u najboljem interesu učenicima/decu.</p>
<p>4. Shkolla është e përfshirë në mënyrë aktive në jetën e komunitetit lokal përmes zbatimit të projekteve të përbashkëta dhe pjesëmarrjes në ngjarjet me interes për komunitetin dhe shkollën.</p>	<p>4. The school is actively involved in life of local community through implementation of common projects in events with interest for community and school.</p>	<p>4. Škola aktivno je uključena u život lokalne zajednice kroz implementaciju zajedničkih projekata i učešće u događajima od interes za zajednicu i školu.</p>
<p>5. Komuniteti i siguron përkrahje materiale shkollës dhe merr pjesë në aktivitete të inicuar nga shkolla.</p>	<p>5. The community ensures material support for school and participate in initiating activities from school.</p>	<p>5. Zajednica obezbeđuje materijalnu podršku školi i učestvuje u aktivnostima koje inicira škola.</p>
<p>6. Nxënësit bëjnë punë vullnetare për të</p>	<p>6. Students do volunteer works to help</p>	<p>6. Učenici dobrovoljno pomažu svojim</p>

<p>ndihmuar moshatarët e tyre në nevojë, pleqtë e vetmuar, familjet e varfëra të komunitetit, përmes grumbullimit të ndihmës në ushqime, veshmbathje, në mjete materiale, etj. për ndihmë të sëmurëve, pastaj t'i ndihmojnë moshatarët që kanë pengesa në mësim, etj.</p>	<p>their coevals in need, lonely elders, poor community families, through the collection of food aid, clothing, in material means etc., for helping the sick people, then to help coevals that have learning difficulties, etc.</p>	<p>vršnjacima u nevolji, usamljenim starcima, siromašnim porodicama u zajednici, kroz prikupljanje pomoći u hrani, odeći, materijalan sredstva itd. pomoć bolesnim zatim pomažu vršnjacima koji imaju smetnje u učenju, itd.</p>
<p>7. Mësimdhënësit njoftohen nga drejtori i shkollës se duhet të angazhohen në punë vullnetarë të natyrave të ndryshme të përmendura më lartë.</p>	<p>7. Teachers are notified by the school principal that should be engaged in voluntary works of different natures mentioned above.</p>	<p>7. Nastavnici su upoznati od strane direktora škole da se trebaju angažovati za dobrovoljni rad različite prirode gore navedene.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 8 Promovimi i shëndetit dhe mbrojtja e mjedisit</p>	<p style="text-align: center;">Article 8 Health promotion and environmental protection</p>	<p style="text-align: center;">Član 8 Promovisanje zdravlja i zaštita životne sredine</p>
<p>1. Shkolla nxit dhe organizon aktivitetete për shëndetin dhe mbrojtjen e mjedisit nga nxënësit, mësimdhënësit dhe komuniteti, përmes aktiviteteve të lira, fushatave të vetëdijësimit, etj.</p>	<p>1. The school promotes and organizes activities for health and environmental protection from students, teachers and community, through leisure activities, self-awareness campaigns, etc.</p>	<p>1. Škola podstiče i organizuje aktivnosti u vezi zdravlja i zaštiti životne sredine od strane učenika, nastavnika i zajednice, kroz slobodne aktivnosti, kampanje osamosvešćivanja itd.</p>
<p>2. Shkolla harton rregulloret në të cilat ndalon pirjen e duhanit në mjediset e shkollës, përdorimin e drogave, të alkoolit, përdorimin e dhunës të formave të ndryshme, etj. dhe merr masa për mosrespektim të rregullores së shkollës.</p>	<p>2. The school compiles regulations in which prohibits smoking in school premises, drug use, of alcohol, use of violence in different forms, etc. and takes measures for disrespect to the school regulation.</p>	<p>2. Škola sastavlja propise u kojima se zabranjuje pušenje cigara u školskim prostorijama, upotreba droga, alkohola, upotreba nasilja različitog oblika, itd. i preuzima mere zbog prekršaja školskih propisa.</p>
<p>3. Shkolla në planin e punës planifikon aktivitetete për mbrojtjen e mjedisit, si</p>	<p>3. School in work plan plans activities for environmental protection, as maintenance of</p>	<p>3. Škole u svom radnom planu planira aktivnosti za zaštitu životne sredine, kao što</p>

<p>mirëmbajtja e hapësirave brenda shkollës, mjedisin e jashtëm, si dhe organizimin e aksioneve për gjelbrimin e mjedisëve përreth si dhe përkujdesin ndaj gjelbrimit, riciklimin e mbeturinave, etj.</p>	<p>spaces within school, external environment, and organizing actions for the greenery of the surrounding environment, garbage recycling etc.</p>	<p>je održavanje prostorija unutar škole, vanjsku sredinu životnu sredinu, kao i organizovanje akcija pošumljavanja sredine u okruženju kao i stara se o zelenilu, reciklaža otpada, itd.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9 Shëtitja</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 The walk</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Šetnja</p>
